



Raporti i vitit 2016

Janar, 01.-31.01.2016

1. Drejtoria e Infrastrukturës Lokale

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale gjatë muajit janar, ka kryer këto aktivitete: kërkesat për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave, shqyrtimin e kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimin e tyre në planet e Komunës, njoftimin me kohë të kompanive publike dhe subjekteve relevante, me qëllim të koordinimit të punëve, incizimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, si dhe kompletimin e dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrjen e realizimit të projekteve sipas marrëveshjes etj.

1.1. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë muajit janar, Drejtoria ka proceduar 196 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike - leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 196 kërkesave të pranuar, 196 janë zgjidhur.

1.2. Dërgimi i kërkesave për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave

Duke marrë për bazë Ligjin mbi planifikimin hapësinorë, Ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive, si dhe Ligjin për projektim, e në veçanti planet rregulluese, janë dërguar kërkesat për hartimin e detyrave projektuese për këto rrugë, në zonat urbane dhe rurale:

- Gjatë muajit janar nuk është dërguar ndonjë detyrë projektuese.

Shënim: Është shpallur njoftimi – tenderi për zgjedhjen e operatorit ekonomik për projektimin e rrugëve me infrastrukturë. (Hartimi i projekteve të infrastrukturës rrugore në Prishtinë 02.02.2016)

1.3. Projektet infrastrukturore të dërguara për ofertim

Nr	Emri i projektit	Vlera e ofertuar
1.	Ndërtimi i rrugëve në lagjen "Veterniku" dhe në lagjen "Mati"	497,340.40 €

1.4. Pjesëmarrja në hapje të tenderëve në projektet infrastrukturore

- Gjatë muajit janar nuk ka pasur hapje të tenderit.

1.5. Pjesëmarrja në vlerësim të tenderëve në projektet infrastrukturore

- Gjatë muajit janar nuk ka pasur vlerësim të tenderit.

1.6. Kontratat në projektet infrastrukturore

- Gjatë muajit janar nuk është lidhur ndonjë kontratë me ndonjë operator ekonomik për ndërtimin e infrastrukturës.

1.7. Raportimi i menaxherëve të projekteve infrastrukturore

- Tash për tash nuk janë duke u ekzekutuar punimet në asnjë kontratë, për shkakë të motit të lig - kushteve atmosferike.

Drejtori :

Hysen DURMISHI, ing.dipl.ndërt.

Janar 2016

Prishtinë